

AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË PRISHTINË, KOSOVË

Bashkim i arkitekturës, diplomacisë dhe mjedisit

Kosova e festoi përvjetorin e 11-të të pavarësisë në vitin 2019 dhe është vendi më i ri i botës. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pasur prani të madhe në këtë krahinë që prej hapjes së Zyrës Informative të SHBA-së në kryeqytet, Prishtinë, në vitin 1996. Gjatë dy dhjetëvjeçarëve e gjysmë, SHBA-ja fuqimisht ka punuar në mbështetjen dhe forcimin e Kosovës përdorur e zhvillon ekonominë, përmirëson sundimin e ligjit dhe stabilizon sigurinë rajonale. Prej vitit 1996, investimet amerikane në Kosovë janë rritur dukshëm, me vendosjen e misionit të përhershëm diplomatik më 1999, që u përcoll me krijimin e ambasadës amerikane në Kosovë në vitin 2008, me shpalljen unilaterale të pavarësisë së Kosovës.

Pas shpërndarjes nëpër shtëpi të ndara në një lagje të kryeqytetit për pothuajse një dhjetëvjeçar, Departamenti amerikan i shtetit pati rastin të konsolidonte misionin e tij diplomatik në Kosovë në një lokacion të vetëm të dhuruar nga qeverisja komunale e Prishtinës me të drejtën e shfrytëzimit për 99 vjet. Lokacioni i ri, një shpatinë mjaft e pazhvilluar në një zonë të përzier komerciale dhe industriale, mundësoi dizajnimin e një kampusi të ri të ambasadës – të sigurtë dhe të qëndrueshëm – që përfaqëson përkushtimin e SHBA-së ndaj Kosovës. Ky lokacion 5-hektarësh në lagjen Arbëria në Prishtinë është i rrethuar me një varg ndërtesash të ndryshme për nga lartësia, materiali ndërtimor dhe përdorimi. Duke parashikuar një lagje më kohezive në të ardhmen, agjencisë rregullative kosovare ia dhanë qeverisë amerikane mundësinë për ta përdorur lokacionin si udhëzues planifikimi urban që do të shfrytëzohej nga zhvilluesit në parcelat përngjitur. Në këtë frymë, ky projekt synonte jo vetëm të paraqiste idealet diplomatike të SHBA-së, por edhe për të përmirësuar misionin e saj duke ofruar një shembull të sigurtë, të qëndrueshëm dhe të avancuar teknologjikisht të arkitekturës, inxhinierisë dhe dizajnit urban amerikan.

Qëllimet + Sfidat

Departamenti amerikan i shtetit synoi një dizajn ndërtimor që tejkalonte standardet e qeverisë amerikane për siguri të dizajneve të misioneve diplomatike për një ndërtesë mikpritëse, transparente, të sigurtë dhe të shquar që nënvizon vlerat e lirisë dhe demokracisë së SHBA-së. Dejvis Brody Bond (Davis Brody Bond) mori përsipër krijimin e tërësishëm të lokacionit dhe dizajnit të ndërtesës që përfaqëson më të mirën e SHBA-së, njëkohësisht duke respektuar dhe përfshirë kulturën, materialet dhe artizanatin vendor – për t’ju treguar kosovarëve se jemi këtu për të qëndruar. Ambasada duhej të ishte vend frymëzues për popullin e vendit nikoqir, si dhe për diplomatët e stafin që punon në kampus. Për shumë njerëz, kjo do të ishte përshtypja e parë për SHBA-në; arkitektura shërben si përfaqësim fizik i diplomacisë. Si e tillë, kampusi i ri i ambasadës duhet ti përmbushte shumë kërkesa: të ishte njëkohësisht e hapur dhe mikpritëse, e sigurtë, efikase dhe e qëndrueshme.

Koncepti + frymëzimi

Liria e posalindur në Kosovë është burim i festimit të vazhdueshëm për popullin e tij. Është kultura e angazhimit shoqëror, brenda e jashtë. Pikërisht kjo nevojë për ndërveprim shoqëror shërben si

frymëzim i konceptit kryesor të projektit: kampus i ndërtesave të vendosura në shpatinat e Prishtinës, të renditura përreth një sheshi qendror të ngjashëm me grupimet historike, rurale ose religjioze të ndërtesave të përqendruara përreth një sheshi të përbashkët. Kampusi përbëhet nga disa elemente kryesore: një kullë afariste pesë-katëshe; qendra e konferencave dhe pavijoni; rezidenca e marinsave; si dhe një punëtori/depo e integruar. Nga aspekti konceptual, dizajni i kullës i ka dy faqe: fasada veriore dhe perëndimore kryesisht janë të ndërtuara nga guri me dritare të futura në brendësi, kurse fasada jugore dhe lindore është krejt me qelq me sistem të jashtëm të strehës nga dielli. Sa i përket punës artizanale vendore me metal si element përkufizues arkitektonik rajonal, streha nga dielli mundëson të paktën 50% të hijes gjatë muajve të nxehtë të verës, duke zvogëluar nxehtësinë, duke filtruar intensitetin e dritës dhe duke ofruar përfitime tjera për siguri. Cilësia dhe ndërthurja e artit dhe zanatit vendor, veçanërisht modelet me ndikim organik të materialit tradicional kosovar, pati ndikim në dizajnin e paneleve me vrima për mbrojtje nga dielli në fasadat e pavijonit të konferencave. Duke përdorur format dhe lidhjet e shprehura në përputhje me këto modele, ndërtesa fiton një nivel të përshtatshëm të “ornamenteve” të zakonshme në këtë rajon. Përveç përshtatjes së dritës natyrore gjatë ditës, panelet krijojnë një fanar të ndritshëm gjatë natës që shpreh qëllimin diplomatik të ambasadës: të respektojë kulturën lokale të vendit nikoqir dhe të jetë mikpritëse për të gjithë popullin e tij.

Planifikimi + pamja

Ambasada është e vendosur në një hapësirë të tiellë që mundëson pamje kah malet në largësi në jug, si dhe pamje nga jugu i Prishtinës. Njëkohësisht, ndërtesa krijon një knd urban të ndërlidhur ngusht me pjesën veriore të zhvilluar të qytetit. Rreshtimi dhe afërsia me këtë kënd paraqet një gjest urban që shpresojmë se do të jetë shembull për projektet e ardhshme. Gjelbrimi në këtë kënd dhe krijimi i parkut përforcon përvojën e kalimtarëve nëpër lagje dhe të vizitorëve të ambasadës. Kampusi i lidhur ngushtë i ndërtesave të ndërlidhura, por të ndara ofron mundësi të mëdha për dizajnimin e peisazhit dhe një lidhje harmonike e tërësore ndërmjet elementeve përbërës të ambasadës dhe lokacioneve përreth. Inxhinierët e peisazheve Roudsaid dhe Haruell (Rhodeside & Harwell) punuan ngusht me Dejvis Brodi Bond për të krijuar një peisazh që kremton ekologjinë, burimet natyrore, klimën dhe peisazhet e larmishme të Kosovës. Duke iu përshtatur lokacionit të natyrshëm të shpatinës, ambasada është vendosur në një peisazh të pjerrtë dhe e fokusuar kah një pellg i madh. Vendosja e këtyre minimizon ndikimin pamor të strukturave nga rrugët e afërta urbane dhe zvogëon shpenzimet për fasadë dhe energji.

Qëndrueshmëria

Ambasada e re ngërthen një numër të strategjive për efikasitet, qëndrueshmëri dhe aftësi të ripërtëritëse, të zhvilluara nga Mejsun dhe Hanger (Mason & Hanger). Sistemi i jashtëm i hijes, çatitë e blerta mbi rezidencën e marincave dhe mbi depo si dhe sistemi hibrid gjeotermal – që shfrytëzon pellgun si amortizues të nxehtësisë – kombinohet për të zvogëluar konsumin e energjisë për më shumë se 45%. Përveç stabilizimit të ngrohjes e ftohjes, pellgu është i domosdoshëm për menaxhimin e ujit nga reshjet dhe ndihmon në zvogëlimin e konsumit të ujit nga ndërtesa për më shumë se 70%. Masat për ruajtjen e ujit baraspeshojnë kërkesat për furnizim vjetor me ujë përmes gjenerimit të ujit nga çatia dhe reshjet, rrjetit eficient të ujit dhe përdorimit të tij brenda ndërtesës, sistemit eficient të ujitjes dhe trajtimit të ujit brenda kompleksit të ambasadës. Masat e tjera për kursimit të energjisë përfshijnë ndriçimin LED, ruajtjen e ndriçimit gjatë ditës, rikthimin e energjisë dhe gjenerimin e ujit të nxehtë termal nga dielli.

Të gjitha këto veçori e ndihmojnë ambasadës për ta përmbushur qëllimin e saj për të marrë çertifikatën e artë LEED BD + C.

Mjedisi i brendshëm i punës

Pjesa e brendshme e ambasadës është dizajnuar për të mundësuar sa më shumë bashkëpunimin dhe për lehtësimin e diplomacisë bashkëkohore e transparente. Mjedisi i brendshëm për punë është i përbërë nga hapësira të qëndrueshme që mundësojnë performancë të lartë dhe një varg të konfiguracioneve. Hapësirat e shpërndara gjithandej i ofrojnë stafit dhe vizitorëve të tyre vende për takime, mbledhje pune dhe për shoqërim. Zonat e përbashkëta të ambasadës përfshijnë një larmi të hapësirave për reprezentacion dhe komunitet që mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë me sheshin qendror për ngjarje.